

Nr. 67 Prot
Δ f. 02.02.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 179/2 Prot.

Tiranë, më 02.02 .2026

Lënda: Për zhvillimin e provimit të shtetit dhe testimin e informatizuar të mësuesit, për kandidatët e suksesshëm në provimin e shtetit, të cilët duan të punësohen në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE
Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr.23, Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Vore

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", të ndryshuar, vendimit nr. 99, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", të ndryshuar, të urdhrin nr. 365, datë 28.12.2020, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për miratimin e Rregullores "Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit", të ndryshuar, urdhrin nr.100, datë 25.02.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", të ndryshuar, udhëzimit nr. 10, datë 03.04.2015 "Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit", i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 8, datë 13.03.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore", të ndryshuar, provimi i shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit dhe testimi i informatizuar i mësuesve, për kandidatët e suksesshëm në provimin e shtetit, të cilët duan të punësohen në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, do të zhvillohen gjatë muajit maj 2026, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

Procedura për regjistrimin dhe pranimin në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit

1. Kandidati, që dëshiron të regjistrohet për pjesëmarrje në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, aplikon online duke përdorur shërbimin e ofruar në Portalin Qeveritar e-albania "Aplikim për provim shteti".
2. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) plotëson të dhënat e kandidatëve dhe konfirmon në sistemin e provimit të shtetit aplikimet për pjesëmarrjen në provim.
3. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) verifikon, kontrollon dhe pranon në sistem, aplikimet e konfirmuara nga ZVAP. Aplikimet e kandidatëve të pranuar nga DRAP kalojnë automatikisht në sistemin e provimit të shtetit.
4. AKAP monitoron procedurat për regjistrimin dhe pranimin në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit.
5. DRAP/ZVAP janë përgjegjëse për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore dhe saktësinë e të dhënave të kandidatëve, të cilat kalojnë në sistemin e provimit të shtetit, brenda afateve të përcaktuara.
6. Kandidati kualifikohet për pjesëmarrje në provimin e shtetit kur:
 - a. Ka kryer me sukses praktikën profesionale;
 - b. Ka rezultuar jo i suksesshëm në sezonet e kaluara;
 - c. Nuk është paraqitur në sezonet e mëparshme;
 - d. Është në marrëdhënie pune dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, në fushën e mësuesisë.
7. Kandidati gjatë aplikimit online ngarkon në sistem dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Diplomën e ciklit të parë të studimit;
 - b. Diplomën e ciklit të dytë të studimit;
 - c. Certifikatën e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale;
 - d. Certifikatën e formimit psiko-pedagogjik, për aplikantët me diploma të njëvlershme, të ngjashme ose të përfaqësuara;
 - e. Vetëm pas pranimit nga DRAP, faturën e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, e cila duhet të ngarkohet në sistem brenda 72 orëve nga pranimi në DRAP.

** Vetëm në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit ose në institucione të arsimit të lartë të mbyllura:*

- Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit;

- Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës/ diplomave, të fituara nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur dhe vërteton vlefshmërinë e tyre.

8. Afatet kohore sipas procedurave

- | | |
|------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| ➤ Aplikimi online për regjistrim në provimin e shtetit | 7-14 prill 2026 |
| ➤ Shqyrtimi i aplikimeve nga DRAP/ZVAP | 7-22 prill 2026 |
| ➤ Shqyrtimi i aplikimeve nga QSHA | 22-30 prill 2026 |
| ➤ Publikimi i kalendarit të organizimit të sezonit | 30 prill-4 maj 2026 |
| ➤ Fillimi i sezonit sipas kalendarit të hartuar dhe miratuar nga QSHA. | |

9. QSHA publikon në faqen e saj zyrtare, www.qsha.gov.al, kalendarin e organizimit të sezonit dhe oraret e pjesëmarrjes në provim për çdo kandidat.

Procedura për zhvillimin e testimit të informatizuar për kandidatët e suksesshëm në provimin e shtetit, të cilët duan të punësohen në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar

Kandidatët të cilët rezultojnë të suksesshëm në provimin e shtetit, menjëherë pas përfundimit të provimit, kanë të drejtë t'i nënshtrohen direkt testimit të informatizuar të mësuesit, për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Programet orientuese të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit dhe fondet e pyetjeve sipas profileve, gjenden të publikuara në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al.

Programet orientuese të testimit të informatizuar të mësuesit, për kandidatët të cilët duan të punësohen në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, gjenden të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar www.ascap.edu.al.

Rezultatet e provimit të shtetit dhe të testimit të informatizuar të mësuesit, për kandidatët të cilët duan të punësohen në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, do të aksesohen nga institucionet nëpërmjet sistemit të provimit të shtetit.

QSHA dhe AKAP raportojnë në MA në lidhje me ecurinë e procesit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

